

VENDIM
Nr. 54, datë 31.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR
PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 35, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 201, datë 16.3.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Shtetit për Diasporën, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shoqata për Autonomi Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

**E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN
E FËMIJËS**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ushtron veprimtarinë e tij bazuar në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e OKB-së Mbi të Drejtat e Fëmijës, marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe në parimet e parashikuara në nenet 5 e 6, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

1.2 Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me funksionimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

1.3 Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet edhe shkurtimet e mëposhtme:

- “Këshilli” - Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- “Agjencia” - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- “Sekretariati” - Sekretariati teknik i këshillit;
- “OJF” - Organizatë jofitimprurëse;
- “Ligji” - Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- “Ministri bashkërendues” - Ministri përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

II. Emërimi i anëtarit dhe mandati i tij

2.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në përbërje të tij ka si anëtarë ministrat e përcaktuar nga Kryeministri, në përputhje me pikën 3, të nenit 35, të ligjit, Avokatin e

Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi vendore dhe 5 përfaqësues të shoqërisë civile.

2.2 Mandati i anëtarëve të Këshillit përfundon:

a) me plotësimin e afatit 4-vjeçar;

b) me lirim nga detyra, për shkak të së cilës ishte anëtar i Këshillit sipas ligjit;

c) në rast dorëheqjeje të përfaqësuesit të Shoqatës për Autonomi Vendore ose të shoqërisë civile. Në këtë rast njoftohet nga sekretariati teknik Shoqata për Autonomi Vendore ose Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, të cilët marrin masa për emërimin e përfaqësuesit/ve të ri/rinj në Këshill, brenda 1 (një) muaji, duke ia komunikuar këtë ministrit bashkërendues;

ç) në rast të mospjesëmarrjes së personit përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore dhe të shoqërisë civile në dy mbledhje të Këshillit në një vit kalendarik.

2.3 Ministri bashkërendues merr masat e nevojshme për ripërtëritjen e anëtarësisë së Këshillit, në rastin e përfundimit të mandatit të anëtarit.

III. MBLEDHJET E KËSHILLIT

3.1 Këshilli mblidhet të paktën 2 herë në vit, me qëllim realizimin e detyrave të përcaktuara në nenet 36 e 37, të ligjit.

3.2 Mbledhja e parë e Këshillit realizohet pa pjesëmarrjen e anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile. Në këtë mbledhje, Këshilli miraton udhëzimin për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, sipas pikës 7, të nenit 35, të ligjit.

3.3 Këshilli Kombëtar ka të drejtë të ngrejë komitete teknike këshilluese për çështje të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të përcaktojë me udhëzim përbërjen dhe rregulloret e tyre.

3.4 Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverisë së nxënësve, organizatave, forumeve, apo çdo grupimi tjetër fëmijësh. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës bëhet me udhëzim të Këshillit.

3.5 Këshilli, në një nga mbledhjet e tij, diskuton lidhur edhe me:

a) raportin e zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020;

b) planifikimin e aktiviteteve dhe të buxhetit për zbatimin e agjendës;

c) financimin nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera nga donatorët.

3.6 Ministri bashkërendues është kryetar i Këshillit, i cili e kryeson dhe e drejton mbledhjen e Këshillit. Ai ka të drejtë të mbledhë Këshillin:

a) në çdo rast që e sheh të arsyeshme, bazuar në situata që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre;

b) kur ka nevojë për ndryshime në politika, në legjislacion, apo për koordinim ndërinstitucional;

c) në rastet e rishikimit/pranimit të raporteve të veçanta për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të hartuara nga institucionet që janë anëtarë të Këshillit.

3.7 Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Këshillit me një kërkesë të argumentuar me shkrim drejtuar kryetarit të Këshillit, ku propozon dhe afatin kohor për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit. Kryetari, pasi shqyrton kërkesën, merr vendimin për mbledhjen ose jo të Këshillit dhe njofton anëtarin që ka kërkuar mbledhjen e Këshillit.

3.8 Kryetari i Këshillit miraton rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit, e cila u dërgohet 15 ditë më parë anëtarëve, përfaqësuesve të Këshillit. Ndryshimi i kohës dhe i vendit të mbledhjes së Këshillit iu njoftohet anëtarëve, jo më vonë se 5 ditë përpara mbledhjes.

3.9 Struktura politikëbërëse në ministrinë bashkërenduese për çështjet e drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe secili anëtar i Këshillit, i propozon ministrit bashkërendues përfshirjen e një çështjeje në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit, të paktën 7 ditë dhe jo më vonë se 2 ditë për çështjet urgjente, përpara datës së mbledhjes. Anëtar i bashkëlidh propozimit të tij edhe argumentimin shpjegues për nevojën e diskutimit të çështjes, si dhe dokumentet mbështetëse, nëse ka.

Mbledhja e Këshillit mbahet kur janë prezentë të paktën 2/3 e anëtarëve. Nëse në mbledhjet e Këshillit nuk janë prezentë 2/3 e anëtarëve, mbledhja nuk zhvillohet dhe kryetari vendos të thërrasë mbledhjen brenda 10 ditëve.

3.10 Propozimet dhe rekomandimet votohen në formë të hapur dhe miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve prezent në mbledhje. Vota e kryetarit të Këshillit është vendimtare, nëse rezultati i votimit është i barabartë.

3.11 Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit duke ushtruar detyrën e tyre funksionale pa pagesë/shpërblim.

3.12 Kryetari i Këshillit ka të drejtë t'u tërheqë vëmendjen anëtarëve për ruajtjen e etikës, kur krijohen situata të cilat pengojnë vijueshmërinë e mbledhjes së Këshillit. Në rastet kur bëhet e pamundur zhvillimi i mbledhjes, Kryetari vendos për mbylljen e saj.

IV. SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT

4.1 Sekretariati i Këshillit përbëhet nga 1 (një) nëpunës që mbulon çështjet e fëmijëve në strukturën përkatëse politikëbërëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 2 (dy) nëpunës nga agjencia.

Sekretariati mbështet funksionimin dhe realizimin e detyrave të Këshillit për:

- a) organizimin e mbledhjeve;
- b) dërgimin e rendit të ditës, së bashku me dokumentet mbështetëse tek anëtarët dhe vëzhguesit;
- c) përfshirjen e çështjeve të propozuara nga anëtarët në rendin e ditës së mbledhjes së radhës të Këshillit;
- ç) njoftimin e anëtarit propozues, nëse nuk përfshin një çështje në rendin e ditës, së bashku me argumentimin përkatës;
- d) përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve urgjente të propozuara nga anëtarët dhe bën shpjegimin përkatës për këto çështje në fillim të mbledhjes;
- dh) mbajtjen e procesverbalit - dokumentimin e diskutimeve, votimeve, rekomandimeve dhe propozimeve të Këshillit gjatë mbledhjeve. Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet për rekomandime e propozime firmosen nga kryetari i Këshillit;
- e) mbajtjen e regjistrit të mandateve të anëtarëve;
- ë) përgatitjen, koordinimin e hartimit të dokumenteve me institucionet dhe strukturat përgjegjëse për çështjet që do të diskutohen në rendin e ditës;
- f) garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve, sipas udhëzimit të Këshillit, bazuar në pikën 7, të nenit 35, të ligjit;
- g) raportimin e progresit, të rezultateve apo të produkteve të punës së Komitetit Teknik të Përhershëm për çështje të caktuara;
- gj) raportimin e statusit të zbatimit të propozimeve dhe të rekomandimeve të marra nga Këshilli në mbledhjet paraardhëse.

4.2 Sekretariati teknik dokumenton në një regjister të posaçëm emërimin, zëvendësimin, kohën e mandatit të secilit anëtar dhe pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Këshillit. Sekretariati i informon anëtarët e Këshillit 6 muaj përpara përfundimit të mandatit.

V. NDJEKJA DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE PROPOZIMEVE TË KËSHILLIT

5.1 Ministri bashkërendues, me ndihmën e strukturës së politikëbërjes në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe agjenci, merr masa për monitorimin, ndjekjen apo/dhe zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, në periudhën mes dy mbledhjeve të Këshillit.

5.2 Ministri bashkërendues ose agjencia, me delegimin e ministrit bashkërendues, raportojnë në mbledhjen e radhës së Këshillit për ecurinë, progresin, sfidat e hasura apo nevojën për ndryshim në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve apo të propozimeve të bëra nga Këshilli në mbledhjen paraardhëse.

